



QENDRA PËR MIRËKUPTIM DHE BASHKËPUNIM INSTITUCIONAL
ЦЕНТАР ЗА РАЗБИРАЊЕ И ИНСТИТУЦИОНАЛНА СОРАБОТКА
CENTER FOR UNDERSTANDING AND INSTITUTIONAL COOPERATION

Adresa: Bul. Krste Misirkov 57 A / 3 - 3, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë
Tel/Fax: + 389 2 3232 186 - Email: info@qmbi.org - www.qmbi.org

ISSN: 1857-8640 (versioni i shtypur)
ISSN: 1857-9396 (versioni elektronik)
UDC 3(497.7:4-672 EU)

THIRRJE PËR DËRGIMIN E PUNIMEVE DHE ARTIKUJVE SHKENCORË CENTRUM NR.8

Të nderuar hulumtues e shkencëtarë!

Në përgatitje e sipër është numri tetë i revistës shkencore ndërkombëtare **CENTRUM** me **IMPAKT FAKTOR** dhe me Bord editorial ndërkombëtar, botuar nga Qendra për Mirëkuptim dhe Bashkëpunim Institucional (QMBI).

Me këtë rast, ftojme të gjithë të interesuarit që të dërgojnë punimet e tyre shkencore për botim në këtë numër të revistës.

Revista ndërkombëtare **CENTRUM** është e bazuar në Ligjin për arsim të lartë të Maqedonisë, si dhe e regjistruar në Bibliotekën kombëtare dhe universitare “Shën Kliment Ohridski” në Shkup, me numër ISSN: 1857-8640 (versioni shtypur), 1857-9396 (versioni elektronik), dhe me UDC të revistës UDC: 3 (497.7:4-672EU). Revista është e indeksuar në:

Google scholar
Rootindexing
Root Impact Factor
Global Impact Factor
International Society of Indexing Impact Factor
University Journals

Përndryshe, revista **CENTRUM** botohet dy herë brenda një viti kalendarik.

Në revistën në fjalë mund të botohen këto lloje të artikujve: punime shkencore, punime profesionale, ekspozë, intervista, recensione, in-memoriam, lajme për ngjarje dhe literaturë profesionale-shkencore.

Gjuhë zyrtare të revistës janë: shqipja, maqedonishtja dhe anglishtja. Është e hapur edhe mundësia e gjuhëve tjera të huaja.

Temat për botim:

1. Nga fusha e drejtësisë, shkencave politike dhe gazetarisë: të drejtës penale, civile, kushtetuese, administrative, ndërkombëtare, të drejtës së BE-së, të drejtave të njeriut,

- politikave zhvillimore, lidershipit, mediave dhe komunikimit, politikës sociale, politikave energjetike;
2. Ndikimi i procesit të integrimi në NATO dhe BE, procesi i tranzicionit dhe reformat në aspektin politik, juridik, ekonomik dhe social;
 3. Konfliktet ndërkombëtare, kontestet, negociatat, si dhe format tjera të zgjidhjes së konflikteve në rajon dhe nëpër botë;
 4. Identitetet nacionale dhe mbinacionale, si dhe globalizmi;
 5. Avancimi i të drejtave të njeriut, të drejtat e pakicave në vendet e rajonit, raste komparative etj.;
 6. Mediat, komunikimi, liria e të shprehurit;
 7. Sfera ekonomike dhe e biznesit: kriza globale ekonomike, recesioni, globalizimi, tranzicioni ekonomik, krimi ekonomik, reformat në sistemin e financave, sistemet financiare alternative, diplomacia ekonomike, menaxhmenti;
 8. Aspekti filozofik dhe sociologjik i proceseve integruese dhe tranzicionit, si dhe ndikimi i tyre në shoqëritë adekuate;
 9. Roli dhe ndikimi i religjionit në proceset integruese;
 10. Ambienti jetësor, kërcënimet ekologjike, shëndetësia dhe reformat në shëndetësi, si dhe sfidat e ndryshme nga fusha e mjekësisë;
 11. Sfera e informatikës: E-governance, e-society, inxhineringu dhe teknologjitë, databazat dhe rrjetet;
 12. Gjuhët, fati i gjuhëve nacionale në “tregun” global.

FORMATI I PUNIMIT PËRFUNDIMTAR:

1. Titulli i referatit duhet të jetë i shkruar në bold, me shkronja të mëdha; teksti duhet të jetë i drejtuar, kurse emri i autorit i vendosur menjëherë më poshtë, kah e djathta. Titulli akademik, institucioni dhe e-adresa duhet të jenë të dhënë në fusnotën e numëruar në fund të faqes.
2. Nën titullin dhe emrin, duhet të jetë i shkruar abstrakti në gjuhën angleze, me madhësi 10, në përbërje prej 250 fjalëve. Abstrakti në gjuhën angleze, gjithashtu duhet të jetë i kyçur në titullin në gjuhën angleze;
3. Fonti duhet të jetë Times New Roman, me madhësi 12. Tabelat, fusnotat dhe referencat tjera duhet të jenë me madhësi 10;
4. Referati duhet të jetë i shkruar në Microsoft Word, në madhësinë adekuate të faqes A4. Margjinat duhet të jenë 2,5 cm, kurse header dhe footer duhet të jenë 1,25 cm;
5. Dokumentet origjinale, fotografitë, hartat, të cilat nuk janë relevante dhe në lidhje direkte me punimin, nuk duhet të jenë të prezantuar në punim, por të njëjtat duhet të jenë të numëruara dhe të paraqiten në fund të punimit;
6. Punimi duhet të jetë 10-15 faqe;
7. Abstrakti dhe përfundimi duhet të jenë në gjuhën angleze;
8. Një autor ka të drejtë të merr pjesë vetëm me një punim shkencor, qoftë si autor apo koautor;
9. Punimet shkencore të paredaktuara dhe të palektoruara nuk do të merren parasysh nga ana e Bordit shkencor.

Datat e rëndësishme:

Afati i fundit për dërgimin e punimeve përfundimtare:

10 nëntor 2017

Data e shtypit:

31 dhjetor 2017

Kostoja:

Publikimi i artikullit kushton **50 Euro**, ndërsa **20 Euro** për çdo bashkautor.

Pagesa e mjeteve prej brenda Republikës së Maqedonisë duhet të bëhet në xhirollogarinë:

CRIS Skopje (denarë)

270.0656088101.26

Halkbank AD Skopje

Pagesa nga jashtë Republikës së Maqedonisë:

CRIS Skopje (valutë e huaj)

Iban: MK07270722000016855

Swift: EXPCMK22

Halkbank AD Skopje

Versionin elektronik të revistës mund ta ndiqni në linkun: **<http://www.centrum.mk/>**

Punimet e juaja shkencore duhet t'i dërgoni në e-mailin: **centrum.qmbi@gmail.com**